



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

19021

UDHEZIM

Nr. 22, Date 5.10. 2011

PER

**PUBLIKIMIN E TE DHENAVE TE BORXHIT TE QEVERISJES SE
PERGJITHSHME DHE HARTIMIN E RAPORTIT TE TIJ**

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes dhe nenit 6 te ligjit nr.9665, date 18.12.2006 "Per huamarrjen shtetere, borxhin shtetor dhe garancite shtetere te huase ne Republiken e Shqiperise", Ministri i Financave

UDHEZON:

Neni 1
Objekti

Objekt i ketij udhezimi jane percaktimi i:

1. Permbajtjes dhe afatit te publikimit te te dhenave te borxhit te qeverisjes se pergjithshme
2. Strukturese se raportit te borxhit te qeverisjes se pergjithshme

Neni 2
Permbajtja e publikimeve

Te dhenat qe publikohen, perfshijne:

- Stokun e borxhit sipas nivelit te qeverisjes se pergjithshme
- Stokun e borxhit te qeverise qendrore sipas
 - burimit te financimit (i huaj, i brendshem)
 - maturimit
 - instrumentave
 - monedhes
 - kreditoreve

- Shumen e emetuar/terhequr gjate periudhes raportuese
- Te dhena per sherbimin e borxhit

Neni 3 Afatet e publikimit

Te dhenat mbi borxhin e qeverisjes se pergjithshme publikohen çdo tre muaj ne faqen zyrtare te internetit te Ministrise se Financave.

Per tremujorin e pare deri ne tretin, publikimi behet jo me vone se fundi i muajit pasardhes. Per tremujorin e katert publikimi behet sipas urdherit te Ministrit per mbylljen e vitit raportues.

Neni 4 Kompetenca per publikimet

Publikimi i treguesve te borxhit duhet te ndjeke kete ruge:

- Te dhenat pergatiten nga specialistet perkates te Drejtorise se Regjistrimit dhe Sherbimit te Borxhit
- Konfirmohen nga Drejtori i Drejtorise se Regjistrimit dhe Sherbimit te Borxhit
- Miratohen nga Drejtori i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjithshme te Menaxhimit te Borxhit Publik dhe i dergohen per publikim Drejtorise se Teknologjise se Informacionit.

Neni 5 Struktura e raportit te borxhit te qeverisjes se pergjithshme

Raporti i borxhit te qeverisjes se pergjithshme eshte pjese e raportit vjetor te buxhetit faktik te pergatitur nga Ministria e Financave per Kuvendin.

Raporti i borxhit te qeverisjes se pergjithshme ka kete strukture:

- Politika e menaxhimit te borxhit
- Realizimi i stokut te borxhit dhe respektimi i kufijve te tij
- Realizimi i shpenzimeve per borxhin ne raport me planin.

Brenda kesaj strukture, çeshtjet trajtohen ne perputhje me problematiken e hasur gjate vitit per te cilin raportohet.

Per zbatimin e ketij Udhezimi ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Menaxhimit te Borxhit Publik.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.


Ridvan BODE
MINISTER